



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 120/2013

Prishtinë, më 1.10.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S–II

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi.

Munguan: Teuta Sahatqija dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Ramiz Fazliu dhe Ismail Berisha nga Ministria e Infrastrukturës dhe Dritan Gjonbalaj nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi–ZPRK, Burim Ejupi –INDEP dhe Flutura Gashi- Rrokum TV.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja mbajtur më 24.9.2013;
3. Raportim i institucioneve ekzekutive në lidhje me gjendjen në aviacionin civil;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.9.2013;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.9.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i institucioneve ekzekutive në lidhje me gjendjen në aviacionin civil;

Kryetari, tha se këtë pikë që e kemi caktuar për sot, ka të bëjë më atë për t'u njohur me gjendjen në aviacionin civil nga përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Autoriteti i Aviacionit Civil, që janë të pranishëm në mbledhje. Kërkoj nga anëtarët e Komisionit që pas prezantimit të raporteve nga përfaqësuesit e këtyre institucioneve, mund të parashtrojnë pyetje. Pastaj fjalën së pari ia kaloi z. Ramiz Fazliu, përfaqësues nga MI-ja për ta paraqitur gjendjen dhe funksionimin e aviacionit civil.

Ramiz Fazliu, këshilltar i ministrit të Infrastrukturës, fillimisht tha që për raportim mbi gjendjen aviacionit civil, ka qanë i ftuar z. Fehmi Mujota, ministër i Ministrisë për Infrastrukturë, mirëpo, për shkak të ndërrimit të orarit të agjendës sot nga Komisioni, nuk ka mundur të jetë prezent. Ai theksoi që ka përgatitur një raport të shkurt me shkrim lidhur me rregullimin e transportit ajror, ku e paraqiti në pika të përgjithshme se si po funksionin Departamenti i Aviacionit Civil, në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, pastaj kërkoj që më anë të pyetjeve që parashtrojnë deputetët mund të ju përgjigjet për të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me Ligjin për aviacionin civil, që janë në kompetencat e MI-së.

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, theksoi se Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për politikat e përgjithshme të funksionimit të Aviacionit Civil. Por, ai theksoi se si përgjegjës i AAC-së mund të flas vetëm për fushëveprimin dhe përgjegjësitë që ka Autoriteti i Aviacionit Civil. Ai theksoi se është i gatshëm për t'iu përgjigjur interesimit të deputeteve për çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimin e AAC-së.

Myzejene Selmani, tha se Ligji për Aviacionin Civil, është njëri prej ligjeve që ka ardhur më pakon e Ahtisarit, prandaj, tani është kohë që të fillohet më ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, pasi që kanë kaluar 5 vite dhe ka ndryshime të shumta rreth kompetencave të Aviacionit Civil, që kanë kaluar nga ndërkombëtarët te institucionet e Republikës së Kosovës.

Pastaj ajo parashtrroi disa pyetje : Cilat janë të drejtat e pasagjerëve gjatë fluturimit në "Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës"? Cilat të drejta ju shkelen më së shumti nga ana e kompanive të fluturimeve? Sa është i sigurt sigurimi i pasagjerëve nga ana e kompanive të fluturimeve? Cilat janë masat që ka ndërmarrë AAC-ja, për sigurinë e pasagjerëve? Sa janë të hyrat nga taksat e ANP-së? Çka keni bërë në rastet kur kompanitë e fluturimeve i anulojnë fluturimet? Për të gjitha këto pyetjeje të parashtruar kërkoj përgjigje në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil.

Hashim Deshishku, tha se jemi pajtuar nga mbledhje e kaluar në Komision, që t'i ftojme përgjegjësit ekzekutivë të aviacionin civil, që janë MI-ja dhe AAC-ja, për t'i diskutuar problemet që po ju paraqiten pasagjerëve, tash sa vjet me biletat e udhëtimeve nga kompanitë e fluturimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Pastaj, parashtrroi disa pyetje siç janë: Pse është hequr garancia bankare për kompanitë e fluturimeve ? A po sanksionohen kompanitë e

fluturimeve pas anulimit të fluturimeve? A është mundësia të ju merret licenca sepse po ju shkaktojnë dëme të mëdha pasagjerëve? Çka po ndodhë që sa vite më këto veprime të njëjta që nuk po ndërmerreni masa për ti parandaluar këto probleme, të cilat po ju paraqiten udhëtarëve e sidomos bashkatdhetarëve tonë, gjatë kohës së pushimeve vjetore?

Kryetari, pyeti për çmimin e lartë të biletave të fluturimeve, pse janë kaq të larta në krahasim më vendet e rajonit? Për marrëveshjen që ka bërë AAC-ja më Zvicrën dhe Turqinë, se a janë në favor të lirit të çmimeve të biletave të udhëtimeve për fluturime dhe sa janë konkurruese?

Dritan Gjonbalaj - Ju përgjigj pyetjeve që kishin të bënin më fushëveprimin e AAC-së. Se sa janë të sigurt pasagjerët, tha që AAC-ja brenda këtyre muajve ka bërë 50 inspektime të aeroplanëve, për ta shikuar sigurinë teknike të tyre. Prej këtyre 50 inspektimeve, asnjë problem teknik nuk e kanë gjetur kontrollorët e AAC-së.

Ai theksoi se sa i përket sigurisë së aeroplanëve, deri më tani nuk kemi pas ndonjë incident serioz. Po ashtu i njoftoi deputetët se ka marr pjesë gjatë gjithë kohës në negociatat për marrëveshjet shtetërore të bëra me vende të ndryshme, duke ofruar asistencë profesionale.

Myzejene Selmani, pyeti për një aeroplan nga Kroacia që ka pas një incident në ANP, se cilat kanë qene shkaqet e këtij incidenti?

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, tha se nuk e kam këtë informatë se ka pas një incident të tillë, por do t'ju njoftojë me shkrim nëse ka pas një incident të tillë.

Ramiz Fazliu, këshilltar i ministrit të Infrastrukturës, ju përgjigj pyetjeve: sa i përket kompetencave të MI-së, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për aviacionin civil, tha që në vitin e ardhshëm MI-ja e ka në plan të fillojë më plotësimin dhe ndryshimin e ligjit në fjalë. Pse është hequr garancia bankare, tha që kërkesa që ishte nga MI-ja që të kërkohej nga kompanitë ajrore që ta kenë një garanci bankare, mirëpo, nga Komisioni Evropian ishte konsideruar si barrierë tregtare dhe në kundërshtim më rregullat e Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Për anulimin e udhëtimeve, tha se udhëtarët duhet të bëjnë ankesat për kompensimin e dëmit. Ai shtoi se gjatë muajt gusht, vetëm dy ditë kemi pas anulime të udhëtimeve nga kompanitë ajrore dhe në këtë kohë kemi pas vetëm 4 ankesa nga pasagjerët. Në rastin e shkeljeve të të drejtave të udhëtarëve MI-ja, ka bërë atë që thotë ligji, duke i ndërmarrë të gjitha masat më anë të procedurave, ku janë hartuar formularët për ankesa që janë publikuar në ueb faqen e MI-së. Për ndërprerjen e licencave, tha se kompanive ajrore, nuk kemi të drejtë t'ua ndërpresim licencat, për shkak të marrëveshjeve ndërkombëtare, por as më ligj nuk është e rregulluar kjo çështje, por ne mund t'ju vëmë gjoba kompanive ajrore, të cilat e kanë shkelur ligjin.

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil - Ju përgjigj pyetjeve për marrëveshjet bilaterale në fushën e aviacionit civil, që i ka bërë Qeveria e Kosovës më Zvicrën dhe me Turqinë. Ai tha se dispozitat e marrëveshjes janë të tipit liberal, që nuk kanë kufizime nga asnjëra palë nënshkruese, sepse me rritjen e konkurrencës, mund të kemi edhe uljen e çmimeve të biletave të udhëtimeve. Çmimi i biletave të udhëtimeve prej disa vendeve këtë vit ka qenë me i ulët për ne në ANP "Adem Jashari"

Shaip Muja, tha se operimi i kompanive ajrore në Kosovë po reflektohet në masë të madhe për shkak të mos liberalizimit të vizave. Arsyeja e mosuljes së çmimeve të biletave të udhëtimeve është edhe mosplanifikimi i duhur gjatë vitit, sepse po kemi fluks të madh vetëm gjatë sezonit të pushimeve vjetore, pra gjatë verës. Për këtë arsye është tërhequr nga Kosova edhe kompania ajrore "British Airways", ndërsa ka falimentuar kompania "Swiss Air". Sa i përket kompanisë

“Belle Air”, kjo më shumë është çështje e konkurrencës që bëjnë kompanitë mes vete, e jo pse “Belle Air” ka pas probleme apo vonesa në aterime etj . Prandaj nga MI-ja dhe AAC-ja, duhet të kërkohej që ti informojnë pasagjerët për të drejtat e tyre më shumë në detaje përmes fletëpalosjeve, apo formave tjera.

Ismail Berisha, drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil në MI- Rreth informimit të pasagjerëve, tha që në ANP, brenda objektit i njoftojnë pasagjeret për të drejtat e tyre me anë të sinjalizimit të monitorëve dhe fletëpalosjeve. Po ashtu edhe në ueb faqen e MI-së, udhëtarët mund të marrin informata më të hollësishme për të drejtat e tyre.

Lutfi Zharku, pyeti pse kompanitë ajrore që aterojnë në ANP, nuk i informojnë udhëtarët gjatë fluturimit në gjuhën shqipe, për rregullat e sigurisë, pikërisht këtë nuk e bënë “Turkish Airlines”?

Sala Berisha- Shala, pyeti se cilat kanë qenë pengesat që Republikës së Shqipërisë që nuk i është lejuar të bëjë kontrollimin në hapësirës ajrore të Kosovës?

Ramiz Fazliu, këshilltar i ministrit të Infrastrukturës, ju përgjigj pyetjes për kontrollimin e hapësirës ajrore, duke thënë që për këtë çështje ka vendosur NATO-ja sepse hapësira e lartë ajrore është në kompetencë të NATO-s. Ai shtoi se ka pas interes edhe nga Italia dhe Austria, për të marrë në kontroll hapësirën ajrore, por NATO, ka vendosur këtë t’ia jep Hungarisë.

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, u përgjigj në pyetjen për mospërdorimin e gjuhës shqipe nga ana e kompanive ajrore. Ai tha, se sipas të drejtave ndërkombëtare, kompanitë ajrore e kanë të obligueshme vetëm përdorimin e gjuhës angleze dhe gjuhën e vendit të tyre, ku kanë marrë licencën dhe për këtë çështje i kam shkruar edhe kompanisë, por ende nuk kam marrë përgjigje.

Lutfi Zharku, tha se sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, udhëtarët kanë të drejtë të informohen në gjuhën e tyre, prandaj, kjo duhet të ju kërkohej kompanive ajrore.

Dritan Gjonbalaj, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, theksoi se është interesuar për këtë çështje që gjuha shqipe të përdoret për ti informuar gjatë fluturimit pasagjerët, mirëpo, ai tha se edhe shumë kompani ajrore të shteteve të BE-së nuk e bëjnë një gjë të tillë.

Komisioni, pas debatit nxori këtë

Përfundim

- 1. Komisioni mbështet institucionet e vendit në përmbushjen e objektivave që kanë ndaj ligjit.*
- 2. Institucionet përkatëse në formë periodike do të informojnë Komisionin me gjendjen dhe sfidat më të cilat përballet në tërësi aviacioni civil në vend.*

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës;

Kryetari, tha se pasi që ky Projektligj, është për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, kërkoi nga anëtarët e Komisionit që të rezervohen për debat dhe të miratohet në parim Projektligji në fjalë, pastaj komentet tyre mund t’i japin gjatë fazës së amendamentimit dhe propozoi të formohet grupi i punës.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës.

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim, Projektligji Nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës;

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Po ashtu Komisioni nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës*
- 2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Lutfi Zharku raportues, Hashim Deshishku, Etem Arifi dhe Ramiz Kelmendi;*
- 3. Secili anëtarë i Komisionit, sipas interesimit mund ti bashkëngjitet Grupit të punës gjatë punës së tij;*
- 4. Grupi i punës në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

5. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

Kryetari, njoftoi deputetët që tryeza “Roli i institucioneve lokale në politika të efijencës të energjisë”, e planifikuar për nesër, shtyhet për shkak se Kryesia e Kuvendi ka caktuar seancë.

Sala Berisha – Shala, kërkoi nga Komisioni që të caktohet një ekspert për hartimin e projektligjit për shërbimin gjeologjik ose ti dërgohet Universitetit të Prishtinës një shkresë për një ekspert.

Kryetari, tha se kjo le të jetë në kompetencën e kryesueses dhe grupit të punës së kush do të caktohet si ekspert.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti